



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 928/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Afijete Sada Glllogjani kryesuese, Zyhdi Haziri dhe Kymete Kicaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e paraqitur nga Kemajl Gegollaj, kandidat për Kuvendin Komunal në Prizren nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega Prizren, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 07.11.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Pranohet** pjesërisht i bazuar Apeli Anr.928/2021 i datës 04.11.2021, paraqitur nga Kemajl Gegollaj, kandidat për Kuvendin Komunal në Prizren nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega Prizren, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021.

**II. Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumëroj të gjitha fletëvotimet e kandidatëve për Kuvendin Komunal në Prizren të subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega Prizren, në Vendvotimet: 2057A/01D, 2017A/01D, 2023A/01R, 2039A/01R, 2021A/02D, 2002A/06R, 2002A/03R, 2001A/02R dhe Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

**III. Rezultati** i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në vendvotimet të vendosura si në pikën **-II- të këtij** dispozitivi të këtij vendimi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

**IV. Refuzohet** e pabazuar pjesa e apelit paraqitur nga Kemajl Gegollaj, kandidat për Kuvendin Komunal në Prizren nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega Prizren, me të cilën ka kërkuar rinumërimin, për vendvotimin: 2042A/017R

## Arsyetim

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.928/2021 nga Kemajl Gegollaj, kandidat për Kuvendin Komunal në Prizren nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega Prizren, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në të cilën kërkon që te rinumërohen vendvotimet 2057A/01D, 2017A/01D, 2023A/01R, 2039A/01R, 2021A/02D, 2002A/06R, 2002A/03R, 2001A/02R 2042A/017R pasi që pretendon se i mungojnë votat e votuesve të tij. Si dëshmi ka bashkangjitur deklaratat e disa votuesve për te cilët pretendon se kane votuar për të.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, pas shqyrtimit të pretendimeve të apelit, materialit zgjedhor dhe provave që gjinden në shkresat e lëndëve, gjeti se:

### **Apeli është pjesërisht i bazuar.**

Paneli vlerësoi se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që, pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, ka konstatuar se ka mospërputhje të votave të kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizrenit Kemajl Gegollaj, kandidat për Kuvendin Komunal në Prizren nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega Prizren, me provat e ofruara nga pala ankuese, siç rezulton edhe nga provat e ofruara si dëshmi nga vet pala ankuese andaj mbi këtë baze dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega Prizren për Vendvotimet: 2057A/01D, 2017A/01D, 2023A/01R, 2039A/01R, 2021A/02D, 2002A/06R, 2002A/03R, 2001A/02R; dhe rezultati i dalur nga ky rinumërim të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të vitit 2021.

Paneli, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparenca, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës se lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon

integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

**Apeli në pikën IV të dispozitivit është i pa bazuar** për arsye se nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se, Kandidati për Kuvend Komunal në Prizren Kemajl Gegollaj, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega Prizren, kërkon rinumërimin e votave për vendvotimin: 2042A/017R, është i pa bazuar për faktin se për të njëjtin vendvotim, KQZ-ja veç ka marrë vendim për rinumërim para se rezultati përfundimtar të publikohet andaj të njëjtat janë të rinumëruara, për këto arsye paneli vlerëson se një rinumërim tjetër për të njëjtin vendvotim të rinumëruara nga KQZ-ja në QNR, është i pa arsyeshëm, për më tepër ankuesi nuk ka ofruar prova shkresore që do ta argumenton se parregullsitë kanë ndodhur me rastin e rinumërimit andaj si te tilla këto pretendime janë të paqëndrueshme.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
Anr.928/21 më datë 07.11.2021

**Kryesuesja e Panelit**  
**Afijete Sada Gillogjani**



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.